



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

Ref. Nr. 01/41

15.07.2024

Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), Shtojca 12 e Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ (MINT) Nr. 04/ 2024 Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjen e regjistrit, për parqet industriale, teknologjike dhe inkubatorët e biznesit.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Departamenti i Industrisë që ta zbatojë Udhëzimin Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta Hajdari

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Industrisë;;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 04/ 2024

PËR

**PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJEN E REGJISTRIT, PËR PARQET
INDUSTRIALE, TEKNOLOGJIKE DHE INKUBATORËT E BIZNESIT**

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-208, për Parqet Industriale dhe Teknologjike (Gazeta Zyrtare Nr. 24, datë 30 Nëntor 2023), shtojcës 12, të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, datë 12.09.2011),

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV(MINT) Nr. 04/ 2024

PËR

PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJEN E REGJISTRIT, PËR PARQET INDUSTRIALE, TEKNOLOGJIKE DHE INKUBATORËT E BIZNESIT

Neni 1

Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet forma dhe përmbajtja e regjistrit për parqet industriale, teknologjike dhe inkubatorët e biznesit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

1.1 Ministria - nënkupton ministria përgjegjëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë;

1.2 Agjencia - nënkupton agjencia përgjegjëse për zhvillimin, administrimin dhe promovimin e parqeve industriale dhe teknologjike, si dhe inkubatorëve të biznesit;

1.3 Park Industrial dhe Teknologjik - nënkupton pronë e paluajtshme e ndarë dhe i rrethuar ku zhvillohen veprimtari ekonomike sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj. Parku Industrial dhe Teknologjik përfshin:

1.3.1 hapësirën e shërbimeve të domosdoshme për shfrytëzuesit;

1.3.2 infrastrukturën e përbashkët duke përfshirë rrugët, rrjetin e energjisë elektrike, rrjetin e telekomunikimit, ujësjellësin dhe kanalizimin dhe lehtësira tjera sipas legjislacionit në fuqi.

1.4 Inkubator - nënkupton hapësirë brenda ose jashtë Parkut Industrial ose Teknologjik, e krijuar për të përshpejtuar rritjen e ndërmarrjeve fillestare përmes shërbimeve mbështetëse.

1.5 Regjistri - është dokument publik, i cili përmban të dhënat për Parqet Industriale dhe Teknologjike, si dhe Inkubatorët e Biznesit brenda Parqeve Industriale dhe Teknologjike në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Regjistri i Parqeve Industriale, Teknologjike dhe Inkubatorët e Biznesit

1. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë do të themelojë regjistrin e të gjitha parqeve industriale, teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit që janë themeluar dhe janë funksionale në Republikën e Kosovës.
2. Agjencia përgjegjëse do të mbajë regjistrin për të gjitha parqet industriale, teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit që janë themeluar në Republikën e Kosovës.
3. Regjistri krijohet, administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Agjencia përgjegjëse.
4. Regjistri është publik, mbahet në formë elektronike dhe fizike, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
5. Komunitat dhe propozuesit varësisht sipas zhvillimeve të parqeve industriale, teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit, duhet të përcjellin të dhënat në Agjencinë përgjegjëse çdo gjashtë muaj
6. Obligohen të gjitha komunitat dhe propozuesit që kanë themeluar parqe industriale, teknologjike dhe inkubator të biznesit, t'i ofrojnë të dhënat e kërkuara nga Ministria sipas nenit 4 dhe 5 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 4

Përmbajtja e regjistrit për parqet industriale dhe teknologjike

1. Regjistri duhet të përmbajë:

1.1. Emrin dhe llojin e Parkut Industrial dhe Teknologjik;

- 1.2. Numrin e parcelës/parcelave;
- 1.3. Sipërfaqen e Parkut Industrial dhe Teknologjik;
- 1.4. Vendimi i themelimit të miratuar nga Qeveria;
- 1.5. Gjendja aktuale e ndërtimit të Parkut Industrial dhe Teknologjik;
- 1.6. Kohëzgjatjen e shfrytëzimit të parkut që mund të jetë nga dyzetë (40) deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet;
- 1.7. Të dhënat për administrimin dhe menaxhimin e parkut sipas nenit 10 dhe 11 të ligjit për Parqe Industriale dhe Teknologjike;
- 1.8. Veprimtaritë që zhvillohen në park;
- 1.9. Shërbimet që ofrohen për bizneset në Parkun Industrial dhe Teknologjik;
- 1.10. Lehtësirat që ofrohen për bizneset e vendosura në Parkun Industrial dhe Teknologjik;
- 1.11. Burimet dhe konsumi i energjisë i vendosur në Parkun Industrial dhe Teknologjik;
- 1.12. Numri i ndërmarrjeve të huaja të vendosura në Parkun Industrial dhe Teknologjik;
- 1.13. Vlera e investimeve nga bizneset e huaja;
- 1.14. Numri i bizneseve sipas veprimtarisë, numri i institucioneve edukative dhe kërkimore;
- 1.15. Numri i të punësuarve total në bizneset e vendosura në Parkun Industrial dhe Teknologjik;
- 1.16. Numri i të punësuarve sipas bizneseve/veprimtarive nga bizneset;
- 1.17. Numri i vendeve të lira në Parkun Industrial apo Teknologjik, nëse ka vende të lira shprehur në numër të parcelave dhe m², për parcelë;
- 1.18. Qarkullimi vjetor i bizneseve;
- 1.19. Eksporti vjetor i bizneseve;
- 1.20. Importi vjetor i bizneseve;
- 1.21. Investimet në hulumtim dhe zhvillim apo inovacione nga bizneset;
- 1.22. Adresa e Parkut Industrial apo Teknologjik;
- 1.23. Kontakti për Parkun Industrial dhe Teknologjik, webmail/email, numër telefoni.

Neni 5

Përmbajtja e regjistrit për inkubatorët e biznesit

1. Regjistri duhet të përmbajë:

- 1.1. Emrin e inkubatorit të Biznesit;
- 1.2. Numrin e parcelës/parcelave;
- 1.3. Sipërfaqen e inkubatorit të Biznesit;
- 1.4. Numrin e bizneseve të vendosura në Inkubator të Biznesit;
- 1.5. Numri i bizneseve të cilat janë zhvilluar dhe kanë dalë nga inkubatori;

- 1.6. Numrin e hapësirave të lira;
- 1.7. Menaxhimi i Inkubatorit të Biznesit - autoriteti publik; shoqëri tregtare organizatë joqeveritare; partneritet publiko-privat;
- 1.8. Veprimtaritë që zhvillohen në Inkubator;
- 1.9. Shërbimet që ofrohen për Biznese në Inkubator;
- 1.10. Lehtësirat që ofrohen për bizneset e vendosura në Inkubator të Biznesit;
- 1.11. Numrin e të punësuarve në Inkubator të Biznesit;
- 1.12. Komuna, ku operon Inkubatori i Biznesit;
- 1.13. Adresën e Inkubatorit;
- 1.14. Kontaktin për Inkubator, webmail/email, numër telefoni.

Neni 6

Shtojcat

1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur këtij Udhëzimi Administrativ janë pjesë përbërëse e tij:

- 1.1. shtojca 1: Përmbajtja e Regjistrit për Parkun Industrial dhe Teknologjik.
- 1.2. shtojca 2: Përmbajtja e Regjistrit për Inkubator të Biznesit.

Neni 7

Dispozita kalimtare

Komunat dhe propozuesit që kanë themeluar parqe industriale, teknologjike dhe inkubator të biznesit, të dhënat e kërkuara nga Ministria sipas nenit 3 paragrafi 6, janë të obliguar ti dorëzojnë në afat prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Neni 13 i Udhëzimit administrativ (MTI) Nr. 15/2016 për mënyrën e themelimit, funksionimit dhe administrimit të inkubatorëve të biznesit.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta Hajdari

Rozeta Hajdari



Prishtinë, 15.07.2024

Shtojca Nr. 1

Shtojca Nr. 1		
Përmbajtja e Regjistrit për Parkun Industrial dhe Teknologjik		
1	Emrin dhe llojin e Parkut Industrial dhe Teknologjik	
2	Numrin e parcelës/parcelave	
3	Sipërfaqen e Parkut Industrial dhe Teknologjik	
4	Vendimi i themelimit të miratuar nga Qeveria	
5	Gjendja aktuale e ndërtimit të Parkut Industrial dhe Teknologjik	
6	Kohëzgjatjen e shfrytëzimit të parkut që mund të jetë nga dyzetë (40) deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet	
7	Të dhënat për administrimin dhe menaxhimin e parkut sipas nenit 10 dhe 11 të ligjit për Parqe Industriale dhe Teknologjike	
8	Veprimtaritë që zhvillohen në park	
9	Shërbimet që ofrohen për bizneset në Parkun Industrial dhe Teknologjik	
10	Lehtësirat që ofrohen për bizneset e vendosura në Parkun Industrial dhe Teknologjik	
11	Burimet dhe konsumi i energjisë i vendosur në Parkun Industrial dhe Teknologjik	
12	Numri i ndërmarrjeve të huaja të vendosura në Parkun Industrial dhe Teknologjik	
13	Vlera e investimeve nga bizneset e huaja	
14	Numri i bizneseve sipas veprimtarisë, numri i institucioneve edukative dhe kërkimore	
15	Numri i të punësuarve total në bizneset e vendosura në Parkun Industrial dhe Teknologjik	
16	Numri i të punësuarve sipas bizneseve/veprimtarive nga bizneset	
17	Numri i vendeve të lira në Parkun Industrial apo Teknologjik, nëse ka vende të lira shprehur në numër të parcelave dhe m ² , për parcelë	
18	Qarkullimi vjetor i bizneseve	
19	Eksporti vjetor i bizneseve	
20	Importi vjetor i bizneseve	
21	Investimet në hulumtim dhe zhvillim apo inovacione nga bizneset	
22	Adresa e Parkut Industrial apo Teknologjik	
23	Kontakti për Parkun Industrial dhe Teknologjik, webmail / email, numër telefoni	

Shtojca Nr. 2**Përmbajtja e Regjistrit për Inkubator të Biznesit**

1	Emrin e inkubatorit të Biznesit	
2	Numrin e parcelës/parcelave	
3	Sipërfaqen e inkubatorit të Biznesit	
4	Numrin e bizneseve të vendosura në Inkubator të Biznesit	
5	Numri i bizneseve të cilat janë zhvilluar dhe kanë dalë nga inkubatori	
6	Numrin e hapësirave të lira	
7	Menaxhimi i Inkubatorit të Biznesit - autoriteti publik, shoqëri tregtare organizatë joqeveritare, partneritet publiko-privat	
8	Veprimtaritë që zhvillohen në Inkubator	
9	Shërbimet që ofrohen për Biznese në Inkubator	
10	Lehtësirat që ofrohen për bizneset e vendosura në Inkubator të Biznesit	
11	Numri i të punësuarve në Inkubator të Biznesit	
12	Komuna, ku operon Inkubatori i Biznesit	
13	Adresa e Inkubatorit	
14	Kontakti për Inkubator, webmail / email, numër telefoni	